

NDIKIMI I RISHIKIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT 2020 NË PROJEKTET KAPITALE TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS VAZHDON TË JETË INSTITUCIONI ME PROJEKTE KAPITALE MË TË MËDHA.

Sipas Ligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2020, për projektet kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit ishin planifikuar të shpenzohen mbi 217 milion euro . (176,986,671 euro plus 40,792,000 euro sipas klauzolës investive). Vetëm për projektet kapitale të dikasterit të infrastrukturës buxheti arrinte shumë prej 170,737,438 € (136,107,438 euro 34,630,000 euro sipas klauzolës investive).

Krijimi i qeverisë së re Hoti solli edhe ndarjen e dikasterit të Ambientit nga Ministria e Infrastrukturës. Propozimi për rishikimin e buxhetit të Kosovës për 2020 ka paraparë zvogëlim të buxhetit për projektet kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës në 148,707,983 € (111,577,983 euro dhe në 37,130,000 euro sipas klauzolës investive).

Sipas një raporti të brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit në fund të vitit 2019, MIA kishte në ekzekutim mbi 200 projekte kapitale.

Gjatë analizimit të projektiligjit për plotësim-ndryshimin e ligjit për buxhetin 2020, respektivisht për projektet kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës KDI ka gjetur se:

- Rishikimi i buxhetit të shtetit për 2020 ka ndikuar që buxheti për projekte kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës të zvogëlohet për 18%.
- Edhe pse ky buxhet është zvogëluar për rreth 18%, asnjë nga projektet e mëparshme nuk është hequr. Në fakt, në listën e projekteve janë shtuar dy projekte që nuk kanë figuruar në tabelën e buxhetit fillestar (Rehabilitimi i rrugëve rajonale dhe Rreth rrotullimet te Rrasat dhe Rija në Rahovec
- Zvogëlimi i buxhetit ka afektuar mbi 90% të të gjitha 240 projekteve kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës.
- Buxhetet individuale për këto projekte janë shkurtuar nga 5% deri në 70% të vlerës së projektit. Vetëm për 21 projekte buxheti nuk është ndryshuar. Mesatarja e zvogëlimit të buxhetit për investime kapitale është 32.4%.
- Vetëm në një rast është vërejtur rritje e buxhetit dhe atë për projektin: Ndërtimi i rrugës " Brigada 123 " - Sheshi në Suharekë.

- Për projektet të cilat kanë pësuar nga shkurtimet e buxhetit nuk është paraparë rritje e buxhetit në vitet pasuese. Kjo është problematike sidomos për projektet për të cilat janë nënshkruar kontratat dhe Ministria ka obligime kontraktuale në vlerën paraprake të planifikuar. Sidoqoftë, shkurtimi i buxheteve do të ndikojë që këto projekte të kontraktohen në vlerë dukshëm më të ulët se që fillimisht janë planifikuar, duke rrezikuar kualitetin e punës.

Projektet infrastrukturore rrugore të njohura për publikun shkak i vonesave në realizim janë prekur gjithashtu nga shkurtime buxhetore për këtë vit si:

Buxheti për rrugët:

- a) Prishtinë – Podujevë është zvogëluar nga 6 milionë në 3 milion euro (50%)
- b) Prishtinë – Pejë është zvogëluar nga 500,000 në 250,000 euro (50%)
- c) Prishtinë – Mitrovicë është zvogëluar nga 3.5 milion në 1.8 milion euro (49%).`

Në projekt propozimin për rishikim të buxhetit janë një numër i konsiderueshëm i projekteve të reja, të cilat nuk ishin paraprakisht të përfshira në ligjin e buxhetit për vitin 2020.

Ky projekt u financua nga Ambasada Britanike në Prishtinë

Ministria e Infrastrukturës	Sektori	Buxheti fillestar 2020	Buxheti i rishikuar 2020	Dallimi €	Dallimi në Përqindje (%)
--------------------------------	---------	------------------------------	--------------------------------	-----------	-----------------------------

**DEPARTAMENTI I
INFRASTRUKTURËS RRUGORE:**

Mirëmbajtja e rrugëve	7,200,000 €	7,100,000 €	100,000 €	-1.4
Programi i sinjalizimit	2,800,000 €	774,788 €	1,225,212.00 €	-72.3
Ndërtimi i urave	2,181,424 €	1,657,731 €	523,693 €	-24
Rehabilitimi i rrugëve	37,547,858 €	33,082,425 €	4,465,433 €	-11.9
Projektet me bashkëfinancim me komuna	21,546,684 €	14,669,939 €	6,876,745 €	-31.9
Ndërtimet e reja të Rrugëve	21,363,477 €	12,547,605 €	8,815,872 €	-41.3
Autostrada	26,522,995 €	26,522,995 €	Nuk ka ndryshim	0

Mesatarja -26.1

Investime kapitale në Departamentin e Automjeteve	10,000 €	5,000 €	5,000 €	-50
Investime kapitale në Departamentin e Aviacionit Civil	15,500,000 €	14,500,000 €	1,000,000 €	-6.5
Investime kapitale në Departamentin e Transportit Tokësor	1,170,000 €	585,000 €	585,000 €	-50
Investime kapitale në Departamentin e Patent Shoferi	250,000 €	125,000 €	125,000 €	-50
Investime kapitale në Shërbimet e Administratës Qendrore	15,000 €	7,500 €	7,500 €	-50

Totali 136,107,438 € 111,577,983 € 24,529,455 € -18

BUXHETI I PROJEKTEVE KAPITALE TË MINISTRISË
SË INFRASTRUKTURËS ËSHTË ZVOGËLUAR PËR

18%

MESATARJA E ZVOGËLIMIT TË
BUXHETIT PËR INVESTIME NË
INFRASTRUKTURË RRUGORE

26%

Ky projekt u financua nga Ambasada Britanike në Prishtinë

RISHIKIMI I BUXHETIT TË SHTETIT 2020 NË PROJEKTET KAPITALE TË MINISTRISË SË INFRASTUKTURËS

Lista e projekteve, buxheti i të cilave nuk është prekur nga projektligji për rishikim të buxhetit 2020:

#	Komuna përfituese	Emri i projektit
1	Gjakova	Zgjerimi i rrugës Dollc – Gjakovë (BK: 500,000 euro + THAKP: 3,5 milion euro)
2	Fushë-Kosovë	Ndërtimi i rrugës Bardhi i Madh - Lismir (28,375 euro)
3	Zveçan	Asfaltimi rrugës Boletin- Rahovë e Madhe (18,757 euro)
4	Komuna e Shtërpçës	Asfaltimi i rrugës Drekoc - Izhancë - Ura e Haxhisë në Shtrëpcë (THAKP: 100,000 euro)
5	Pejë	Rruga Shtupeqi i Madh në Peje (146,655 euro)
6	Deçan	Asfaltimi i rrugëve Strellc i Epërm - Drenoc , lidhja me rrugën magjistrale (BK: 100,000 euro + THAKP: 300,000 euro)
7	Obiliq	Renovim i Rrugës Llapi në Obiliq R-120 (10,696 euro)
8	Kaçanik	Asfaltimi i rrugës Triumf Riza në Stagovë, Komuna e Kaçanikut (THAKP: 30,247euro)
9	Kaçanik	Zgjerimi i rrugës Avdurrahim Shehu, Komuna e Kaçanikut (THAKP: 54,922 euro)
10	Kaçanik	Ndërtim i rrugës Idriz Seferi, Komuna e Kaçanikut (THAKP: 13,461 euro)
11	Deçan	Rruga në Bjeshkën e Strellcit, Deçan (THAKP: 200,000 euro)
12	Suharekë	Ndërtimi i rrugës " Brigada 123 " - Sheshi në Suharekë (nga 100,000 në 275,000 euro)
13	Ferizaj	Asfaltimi i rrugës Prelez i Jerlive – Muhoc – Lloshkobare (26,690 euro)
14	Pejë	Asfaltimi i rrugës në Drelaj – Llutov – Pepaj (34,083 euro)
15	Podujevë	Asfaltimi i rrugës Ballaban - Orllan (te liqeni) (57,420 euro)
16	Drenas	Rruga rreth hekurudhës prej udhëkryqit Glogoc - Ruboc deri te stadioni i qytetit Lipjan (214,277 euro)
17	Drenas	Ndërtimi i rrugës Gradicë – Zhilivodë, Drenas (156,496 euro)
18	Suharekë	Ndërtimi i rrugës Nishorë – Kërvasari, Suharekë (15,051 euro)
19	Prishtinë	Ndërtimi i rrugës A në Komunën e Prishtinës (THAKP: 1,000,000 euro)
20	Rajonale	Autostrada Prishtinë – Hani i Elezit (R6) (BK: 9.8milion + THAKP: 2.2 milion euro)
21	Rajonale	Rruga Nacionale Prishtinë – Gjilan – Konqul (BK: 2.242,398 euro + THAKP: 12,280,597 euro).

Ky projekt u financua nga Ambasada Britanike në Prishtinë